

Mbi rrezikun e korporatizmit në drejtësi

Artikull nga Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive e Komitetit Shqiptar të Helsinkit

Një nga nevojat kryesore për krijimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP) dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ), dy organet e qeverisjes përkatësisht të prokurorëve dhe gjyqtarëve ishte pikërisht ç'montimi i korporatizmit në drejtësi. Në veprimtarinë e mëparshme të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë (i cili nuk ekziston më) ishin vërejtur elementë të korporatizmit në procesin e emërimeve, promovimit në detyrë dhe proceseve disiplinore të gjyqtarëve. E njëjta problematikë ishte vërejtur edhe në veprimtarinë e Prokurorit të Përgjithshëm, i cili para reformimit të drejtësisë ishte përgjegjës ndaj karrierës dhe disiplinës së prokurorëve.

Korporatizëm në drejtësi edhe pse nuk ka një përkufizim shkencor është një fenomen që u referua në analizën e kryer nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi, për nevojën e reformimit të drejtësisë, për faktin se institucione (kolegjiale apo individuale) të drejtësisë në atë kohë ushtronin kontroll dhe favorizime të papërshtatshme ndaj prokurorëve dhe gjyqtarëve, duke mbrojtur interesa jolegjitime dhe klienteliste. Kjo është konstatuar edhe në një raport të posaçëm studimor të Komitetit Shqiptar të Helsinkut, të vitit 2019 gjatë veprimtarisë trazitore të institucionit të mëparshëm, KLD-së, ku në disa prej rasteve të procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve, pyetjet e anëtarëve të këtij institucioni ndaj gjyqtarëve të thirrur në seancën dëgjimore dhe qëndrimet e tyre kanë patur nota të dukshme favorizuese.

KLP dhe KLGJ u ngritën me një vonesë 2 vjeçare, në Dhjetor të vitit 2018. Vendimmarrjet e institucioneve të reja të drejtësisë është e nevojshme të analizohen më shumë, nga ekspertë të fushës, juristë me përvojë, pedagogë, por edhe nga gazetarë që mbulojnë çështjet e drejtësisë. Kjo për arsye se rreziku i korporatizmit ekziston edhe tek organet e reja të drejtësisë.

Në këtë shkrim duke patur parasysh angazhimin e organizatave të shoqërisë civile dhe Komitetit Shqiptar të Helsinkit, dëshiroj të ndalem tek një ngjarje e rëndë që ka tronditur opinionin publik, 2 vjet më parë. Në datën 21 Shkurt të 2020-ës, në Burgun 313 “Jordan Misja”, u gjet i vetëvrarë në qelinë e tij me një çarçaf, shtetasi i paraburgosur me origjinë nga Kukësi, i moshës 43 vjeç. Ky shtetas, u akuzua nga prokuroria për vjedhjen e një portofoli në vlerën 12,000 Lek të reja. Në atë kohë, familjarët denoncuan në emisionin investigativ Stop, në Tv Klan, duke pretenduar se praktika e caktimit të masës së sigurimit personal “arrest në burg” është shoqëruar me shkelje të garancive të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë filloi procedimin disiplinor ndaj magjistrates prokurore ndërkohë që Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka rrëzuar kërkesën për masë disiplinore të ILD-së, me shumicën e anëtarëve.

Një proces penal që nuk filloi, pavarësisht kallëzimit penal të familjarëve të të ndjerit

Lidhur me të njëjtën çështje, familjarët e të ndjerit kanë depozituar një kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, ndaj magjistrates. Kjo prokurori ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, vendim i cili është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Shkallës së Parë Durrës. Duke qenë se ky vendim ishte ankimuar në Gjykatën e Apelit Durrës dhe rrjedhimisht, ndaj prokurores subjekt procedimi disiplinor, në të njëjtën kohë dhe për të njëjtin fakt ishte paraqitur një kallëzim penal, për të cilin gjykata nuk ishte shprehur me vendim të formës së prerë, KLP vendosi pezullimin e këtij procedimi disiplinor deri në administrimin e vendimit të Gjykatës së

Apelit. Pasi kjo e fundit vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Durrës, duke legjitimuar vendimin e mosfillimit të procedimit penal ndaj prokurores, KLP vendosi të revokojë vendimin për pezullimin e procedimit disiplinor dhe të vijojë me procedurën për shqyrtimin e çështjes në seancë plenare.

Kur kam lexuar vendimin e KLP-së për rrëzimin e kërkesës së ILD-së për caktimin e masës disiplinore ndaj magjistrates prokurore, më kanë tërhequr në mënyrë të veçantë vëmendjen këto dy elementë:

- Seanca dëgjimore me magjistraten është zhvilluar me dyer të mbyllura nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, ndërkohë që çështja mbart interes të lartë publik. Në vendimmarrjen e KLP-së nuk konkretizohet asnjë rrethanë faktike se në cilat kushte u vlerësua realizimi me dyer të mbyllura të mbledhjes, por u mjaftua thjesht dhe vetëm me referimin e bazës ligjore përkatëse. Sipas nenit 142, pika 2, gërma “b” të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, Këshilli, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë zhvillimin e seancës me dyer të mbyllura, në rastet kur është e nevojshme të mbrohet e drejta e jetës private, të mbrohen të dhënat personale të magjistratit ose një personi tjetër. Është e paqartë se privatësia e kujt mbrohet në këtë seancë, pasi të paktën nga familjarët e viktimës çështja është bërë me nismën e tyre publike.
- Sipas kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, mosveprimi i prokurores nuk rezulton të jetë shkak i vdekjes së shtetasit B.H, ndërkohë që KLP duke marrë parasysh faktin që për të caktuar një masë disiplinore duhet të ekzistojë jo vetëm shkak (ose shkelja) por edhe pasoja, vëren se mungesa e pasojës bën që magjistratja të mos jetë përgjegjëse disiplinarisht. Ky argument në vlerësimin tim nuk qëndron pasi shkeljet e konstatuara, nëse nuk do të ishin kryer, mund të kishin parandaluar kufizimin e lirisë së këtij shtetasi dhe rrjedhimisht edhe aktin e vetëvrasjes në kushtet e privimit të lirisë. Sipas Kodit të Procedurës Penale, çdo masë sigurimi duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Ndërkohë që arresti në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit. Nëse prokurorja e çështjes do ishte njohur me provat e avokatit mbrojtës (i cili ka gjithashtu përgjegjësinë e tij për mos relativimin e tyre në seancë duke cënuar mbrojtjen efektive), a do kishte kërkuar ajo të njëjtën masë sigurimi? Përveç cenimit të parimit të kontradiktoritetit që çdo provë i nënshtrohet debatit në seancë, është gjithashtu e ditur që gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të ashpër se ajo e kërkuar nga prokurori i çështjes. Pra roli që prokurori ka në një proces të tillë, i cili pavarësisht se nuk është gjykim në themel, ka rëndësi thelbësore pasi diskutohet dhe vendoset për vlefshmërinë e arrestit në flagrancë ose ndalimit dhe më pas për kufizimin ose jo të lirisë në mënyrë të përkohshme (duke aplikuar masat e sigurimit). Besoj që asnjë magjistrat, qoftë ky prokuror apo gjyqtar, nuk do të dëshironte ardhjen e pasojave të tilla për viktimën. Por kur analizohet një shkelje disiplinore, pasoja nuk mund të shikohet në një prizëm kaq të ngushtë por se sa dhe si, respektimi i detyrimeve procedurale mund të parandalonte ardhjen e pasojës.

Ankesa e 19 organizatave të shoqërisë civile

Në ankesën e tyre, organizatat e shoqërisë civile referojnë se, standardet ndërkombëtare inkurajojnë me forcë mos përdorimin e masave shtrënguese të kufizimit të lirisë gjatë hetimit dhe gjyqimit penal, deri në dhënien e vendimit. Nisur nga praktika gjyqësore e Gjykatës Europiane të

të Drejtave të Njeriut, në këndvështrim të nenit 5 KEDNJ (e drejta për liri dhe siguri) do të ishte e papranueshme që të kufizosh lirinë e një individi me çrregullime të shëndetit mendor, në një mjedis të përshtatshëm terapeutik.¹ Përdorimi i zgjeruar i arrestit në burg në vendin tonë evideton një njohje jo të mirë të tyre nga aktorët e sistemit të drejtësisë penale. Në praktikën e caktimit të masave të sigurimit, vërehet se masa e sigurimit personal ‘arrest në burg’ është një ndër masat e kërkuara për shumicën dërrmuese të të pandehurve nga prokuroria, edhe për vepra penale apo të pandehur që nuk paraqesin rrezikshmëri të lartë.

Caktimi i masës së sigurimit personal ‘arrest në burg’ mund të shmangej ndaj shtetasit B.H dhe të zbatoheshin alternativa më të lehta të kësaj mase. Përveç se nuk ka kryer një vepër penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore, izolimi i këtij shtetasi të diagnostikuar me çrregullime të shëndetit mendor në paraburgim, solli pasoja tragjike në jetën e tij. Prova e vetme kundërshtuese e referuar nga ana e mbrojtësit të caktuar kryesisht rezultoi vendimarrja e Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë në Punë (KMCAP) për trajtimin e këtij shtetasi me kemp, i bazuar në diagnostikimin e tij me “*skizofreni*”, element i cili duhej të merrej në konsideratë si nga Prokurori por edhe nga gjykata, në raport me rrezikshmërinë e ulët të veprës penale për të cilën akuzohej i pandehuri.

Mendimi paralel i tre anëtarëve të KLP-së

Tre anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, janë dakord me vendimin e shumicës për rrezikimin e kërkesës së ILD-së por argumentat e tyre janë akoma më lehtësues për pozitën e magjistrates. Sipas tyre, gjatë shqyrtimit të seancës së vleftësimit të arrestit dhe caktimit të masës së sigurimit, jo domosdoshmërisht prokurori duhet të shprehet në lidhje me dokumentet e paraqitura në seancën e vleftësimit të arrestit dhe caktimit të masës së sigurimit nga ana e mbrojtësit, për pasojë, prokurorja nuk ka shkelur asnjë rregull procedural në lidhje me administrimin e këtyre akteve në dosjen gjyqësore, sa kohë në Kodin e Procedurës Penale nuk ka asnjë detyrim të shkruar për këtë moment procedural.

Mendim Pakice (një anëtar i KLP)

Vetëm një prej anëtarëve të KLP-së ka mbetur në pakicë në këtë vendimarrje. Sipas vlerësimit të tij, në respekt të parimit kushtetues të procesit të rregullt ligjor, prokurori e ka për detyrë të njihet me aktet e depozituara në seancë nga pala mbrojtëse, për t’u siguruar për pranueshmërinë e tyre si prova si dhe për të rishikuar nëse është rasti, pozicionet e tij, pavarësisht detyrimit të gjykatës për të bërë të njëjtat verifikime. Dështimi i prokurores për tu njohur me provat e paraqitura nga mbrojtja në seancën e vleftësimit të masës së sigurisë, jo vetëm që përbën shkelje të rregullave dhe parimeve të procedurës penale, por për më tepër ka sjellë dëme për palët në proces, duke zbehur objektivisht mundësinë e aktorëve të tjerë të sistemit për të disponuar me masa të përshtatshme që do të adresonin në mënyrë adekuate problemet që erdhën më pas, për shkak të shëndetit të brishtë mendor të shtetasit B.H.

¹ Çështja *Hutchison Reid v. the United Kingdom*, 50272/99, 20.02.2003.